

Itinerar me 50 tempuj do të tërheqë turistët në Bullgari dhe Rumani



Mbi 50 manastire të njohura dhe jo aq të njohura, kisha, xhami, sinagoge dhe vende të tjera të shenjta në territorin e qarqeve Dobriç (të Bullgarisë) dhe Konstanca (të Rumanisë) presin turistët.

Itinerari turistik, i cili kalon përmes të gjitha këto objekte është përpunuar në bazë të projektit të Institutit Evropian për Turizëm Kulturor “Evrika” në qytetin e Dobriçit dhe të fondacionit humanitar “Clopot” në Konstancë. Përkrahja financiare për të është ofruar nga Programi për zhvillim transkufitar “Interreg V-A Rumania - Bullgaria”.

Për të vizituar të gjitha vendet e parashikuara në këtë itinerar turistët mund të përdorin aplikacion mobil falas. Projekti parashikon dhe shëtitje me jahtë buzë bregdetit bullgar dhe atë rumun.

Po të ketë interes mund të organizohen itinerare etnografike dhe dasma.